



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 47

Prishtinë, më 13.10.2016, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Salih Salihu, Haxhi Shala, Shaip Muja dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Murat Hoxha, Emilija Rexhepi dhe Sërgjan Popoviq.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 29.9.2016 dhe 7.10.2016;
3. Shqyrtimi i vazhdimet të punës së grupit punues të themeluar më 18.3.2015;
4. Shqyrtimi i draft rekomandimit për mbledhjen plenare për çështjen e Hades;
5. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua me plotësimin për pikën të ndryshme:

- Për tërheqjen e Raportit me rekomandime për Projektligjin për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit nga komisionet e përhershme dhe plotësimin e tyre, propozim i deputetit Shaip Muja.
- Ndotja e mjedisit nga gomat e djegura të kompanisë “Fitoprojekti, në fshatin Mirosalë të Ferizajt , propozim i deputetit Adem Salihaj.
- Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen nga Zhurma, propozim i kryetares Duda Balje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.9.2016 dhe 7.10.2016;

Procesverbalet e mbledhjeve të datës 29.9.2016 dhe 7.10.2016, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i vazhdimit të punës së grupit punues të themeluar më 18.3.2015, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz;

Duda Balje, kryetare pasi prezantoi të ftuarit për këtë pikë të rendit të ditës, z. Idriz Blakaj, drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve memorialë të Kosovës (AMKMK), z.Musa Dragusha, nga Oda e avokatëve të Kosovës (OAK),ia dha fjalën deputetit **Shaip Muja**, i cili foli për nismën e cila daton që nga muaji mars i vitit 2015, dhe përgatitjen e këtij Projektligji, i cili tha Muja i plotëson të gjitha kushtet të trajtohet, pas një korrigjimi dhe lekturimi.

Idriz Blakaj, tha se fillimisht në vitin 2015 është marrë qëndrim në Komision të formohet një grup punues për të përgatitur draft ligjin, ku ishin deputeti Lahi Brahimaj, si kryesues dhe anëtarët Shaip Muja, Murat Hoxha dhe Haxhi Shala edhe ne si agjenci, mirëpo, kjo punë u zvarrit për shkak të situatës në parlament.

Grupi punues na ka autorizua si Agjenci të bëjmë një draft, por meqë s’kemi ekspertë biseduam me Odën e Avokatëve dhe me Murat Jasharin dhe OAK-u e caktoi kryetar të GP avokatin Musa Dragusha. NE kemi mendu që sot para jush ta paraqesim draftin, të plotësohet grupi punues, pasi që mungon Lahi Brahimaj, të zëvendësohet ai dhe të zgjerohet me Odën e Avokatëve.

Projektligji është i mirë. Pajtohem se mund të ketë gabime gjuhësore dhe teknike, ju jeni ata që vendosni për këtë.

Musa Dragusha, tha se në bashkëpunim me Agjencinë, kemi nisur që nga 12 maji e deri më 20 gusht 2016, ku kemi angazhuar 12 ekspertë dhe një ekspert nga Departamenti Ligjor i MFSK-së, kapitulli për gardën ceremoniale të FSK-së, është i hartuar nga ky departament. Këtij grupi i kanë ndihmuar historianë, etnologë, arkitektë, dhe ekspertë financiarë, gjithsej 22 ekspertë të lëmenjve. Draftit i mungon lektura dhe korrektura. Ekziston Ligji bazik i miratuar në vitin 2004, i miratuar nga Kuvendi nën autoritetin e IPVQ-ve administrimin e UNMIK-ut, mirëpo, pas shpalljes së pavarësisë e tërë rregullativa ligjore është rirregullua dhe ky është i vetmi ligj që nuk është ndryshua. Ligji

bazik i ka vendosë vetëm dy mekanizma të rëndësishëm: këtë kompleks e shpall zonë me interes të veçantë dhe e dyta e ndalon aktivitetin politik.

Ai e paraqiti përmbajtjen e Projektligjit, ku rregullohet shpallja e kompleksit zonë me interes të veçantë, që rregullohet me Planin Urbanistik të Komunës së Skenderajt dhe me planin hapësinor të Kosovës, pastaj përfshihet konservimi, restaurimi dhe rindërtimi, manifestimet brenda hapësirave, Garda Ceremoniale me një objekt dhe hapësira përcjellëse të nevojshme.

Financimi dhe implikimet financiare të këtij Projektligji, mbikëqyrja, përkujdesja dhe mirëmbajtja e Kompleksit Memorial...

Time Kadrijaj, falënderoi grupin që e ka përgatitur këtë draft dhe tha se kjo punë më në fund po rregullohet dhe se Kompleksi “Adem Jashari”, e meriton të trajtohet ashtu siç duhet.

Salih Salihu, tha se Projektligji përfshinë shumë gjëra me interes për Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, dhe ne e përkrahim këtë ngase nuk kemi kompleks më të rëndësishëm. Kompleksi përfshinë sipërfaqe të madhe, ku duhet të shpronësohen rreth 450 hektarë dhe me siguri kjo do të ketë implikime buxhetore.

Duda Balje, pyeti se kanë kontaktuar me Ministrinë e Financave, në lidhje me çështjet financiare, ndërsa **Idriz Blakaj**, sqaroi se për shpronësim janë, jo më shumë se 17 hektarë tokë përmbi varreza ku parashihet parku, 6 objekte familjare dhe objektet e Jasharajve. Nuk ka ndikime të mëdha buxhetore, Agjencia e ka krye elaboratin për shpronësim, i cili është dorëzua në MMPH.

Adem Salihaj, theksoi se procedurat për miratimin e një ligji janë parapa me rregulloren e Kuvendit. Paraprakisht është dashtë të keni konsultime me MMPH-në sepse është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e kësaj ministrie. E domosdoshme duhet të jetë deklarata financiare...

Duda Balje, tha se pasi të përgatitet drafti së bashku me dokumentet përcjellëse: memorandum i shpjegues, deklarata financiare, deklarata për përputhshmërinë me legjislacionin e BE-së dhe përkthimit në 3 gjuhë, duhet të përcillet përmes Kryesisë së Kuvendit në Qeveri dhe pas një muaji kthehet në Kuvend, ku ne mund ta procedojmë për lexim të parë në Seancë.

Haxhi Shala, falënderoi të gjithë ekspertët që kanë punuar në këtë draft dhe shtoi se në kohën kur kemi filluar si grup punues kemi pas vështirësi, ndërsa ky draft po shihet se është një material i mirë dhe si grup shpejt do ta procedojmë më tutje, kurse **Shaip Muja**, shtoi se grup punues do të përgatisë edhe deklaratat financiare dhe elementet e tjera që kërkohen, ku ai propozoi që të jetë edhe grupi i profesionistëve nga Agjencia dhe Oda e Avokatëve, propozim që e mbështeti edhe **Adem Salihaj**...

Në fund Komisioni vendosi, që Grupi punues i themeluar më: 18.3.2015 të vazhdojë punën tash në këtë përbërje: Shaip Muja, kryesues, Haxhi Shala, Murat Hoxha dhe Time Kadrijaj, anëtarë.

4. Shqyrtimi i draft rekomandimit për mbledhjen plenare për çështjen e Hades

Duda Balje, për çështjen e Hades tha se pas disa takimeve me institucionet e ndryshme, me banorët dhe vizitës që bashkë me anëtarët e Komisionit kemi bërë në terren, kemi biseduar rreth përgatitjes së një rezolute për Kuvend, kërkoi propozimet e anëtarëve, duke theksuar problemin e këtyre banorëve , të cilët kanë nevojë për ndihma konkrete dhe shtroi domosdonë që për këtë çështje të takohen edhe me kryeministrin.

Shaip Muja, tha se e ka përgatitur një draft të kësaj rezolute, që ka nevojë të plotësohet me disa të dhëna. Për çështjen e dislokimit të banorëve të Hades, duhet ta analizojmë zbatimin e disa ligjeve në fuqi ngase banorët kanë kushte mizore jetese aty. Forma e dislokimit është shumë e lehtë nëse ekziston vendimi politik, ndërsa ne duhet të japim një rekomandim për MMPH-në, MZHE-në në seancë plenare. Në draft duhet të përcaktohet numri i përgjithshëm i kryefamiljarëve.

Në vitin 2004, ka filluar eksproprijimi i tokës dhe një plan ku është thënë se më 2012 - 2017 do të dislokohet edhe Hadja dhe Shipitulla. Tash ka ndryshuar plani dhe se deri më 2024 ose 2033 nuk ju nevojitet ajo pjesë. Banorët janë të rrethuar si një oazë nga mihjet, zhurma, ndotja e ambientit dhe deponia e mbeturinave. Ne duhet të përcaktojmë numrin njerëzve që janë kryefamiljarë sepse familjet janë zhvilluar.

Në takim me kryetarin e Komunës së Obiliqit, kam kërkuar që t'i dërgojnë të dhënat për kryefamiljarë. Janë 800 troje të planifikuara në Shkabaj, dhe propozimi do të bëhet që atyre tu jepen trojet e Qeveria të gjejë një pjesë të mjeteve, me ç'rast duhet të bisedohet edhe me donatorë, siç është Banka Botërore...

Adem Salihaj, tha se ne duhet sa më shpejt ta bëjmë një raport me rekomandime për këtë çështje të cilën në Kuvend do ta shndërrojmë në Rezolutë që ta obligojë Qeverinë të ndër marrë hapat e duhur. Pas bisedave me banorët dhe daljes në terren dhe diskutimeve me institucionet e ndryshme përfshirë edhe Avokatin e Popullit, nuk asnjë dilemë se atje ka shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe se banorëve të mbetur u është pamundësuar jeta. Gjysma e fshatit është shpronësuar e gjysma tjetër jo, prandaj mendoj se duhet të shpronësohet Hadja në tërësi dhe atyre tu gjendet një zgjidhje tjetër në Shkabaj apo gjetiu. Nëse MMPH-ja pas të gjitha këtyre fakteve nuk ndërmerr hapa atëherë ne do të bëjmë rekomandime ose Rezolutë për Kuvendin.

Salih Salihu, tha se në Hade nuk ka kushte për jetë për shkak të tejkalimeve të standardeve mjedisore, ku sipas disa raporteve, ka tejkalime të ndotësve deri në 30 herë më shumë se sa vlera e lejuar si dhe paraqitjet e sëmundjeve të mushkërive të banorët. Hadja dhe në strategjinë e energjisë, planin hapësinor është shpallur zonë me interes nacional. Në faqen 118, shihet qartë nga hartua e planit zhvillimor hapësinor se deri në vitin 2017 është parapa dislokimi i Hades. Më vonë ka kjo ndryshoi dhe u shty. Janë larguar vetëm lagja Shala, ndërsa lagja Grajçevci jo. Fshati Hade i ka 400 shtëpi, ndërsa Qevëria duhet të ndajë rreth 820 troje. Salihu pyeti pse në lagjen Mirena , kur dihet se s'ka kushte për jetë, ndërtohet pa leje. Kush janë ata që po ndërtojnë dhe a ka inspektim për këtë, sepse kjo do të kushtojë buxhetit të Kosovës më vonë.

Time Kadrijaj, tha se gjendja është alarmante dhe shqetësimin qytetarët e kanë adresuar te deputetët. Banorët e asaj pjese janë më shumë të atakuar me sëmundjen e kancerit, prandaj e kemi obligim me shpejtësi të veprimjeve edhe për çështjen e zhvendosjes edhe të Ligjit për Obiliqin, kurse **Haxhi Shala**, propozoi të shkohet me një propozim konkret, me një letër Kryesisë së Kuvendit, kjo çështje javën tjetër të futet në rendin e ditës, të vijë ministrat të raportojnë dhe të nxjerrim disa rekomandime para se buxheti të planifikohet për vitin 2017.

Shaip Muja, tha se nuk ka nevojë ta thërrasim ministrat sepse ata kanë me tregu për strategjitë e veta, që i kemi edhe ne. Aty ka shkelje të të drejtave të njeriut dhe ne duhet të bëjmë rekomandime. Duhet të bëjmë një specifikim, sa shtëpi duhet zhvendosur. Pra, janë 820 troje në Shkabaj të planifikuara, aty janë dislokuar vetëm 65 shtëpi e kanë mbetur edhe 770 troje për ndërtim. Kontingjenti i parë me 150 shtëpi të fshatit Hade dhe pjesën e Shipitullës.

Në fund të debatit u vendosë që javën e ardhme të ftohet në mbledhjen e Komisionit ministri i MMPH-së dhe (kryeministri) ose përfaqësuesi i Zyrës së Kryeministrit.

5. Të ndryshme.

- **Për tërheqjen e Raportit me rekomandime për Projektligjin për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit nga komisionet e përhershme dhe plotësimin e tyre – propozim i deputetit Shaip Muja.**

Shaip Muja- Pasi që raporti me rekomandime për Projektligjin për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit i datës 14.4.2016, i kemi dërguar në Komisionet e përhershme dhe akoma nuk kemi marrë përgjigje nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozoj që t'i tërheqim amendamentet edhe njëherë në Komision dhe sot të marrim vendim si Komision dhe ti rregullojmë 2 nene. Nenin kryesor e kemi të renta minerale por që më parë s'mund ta bënim dhe tash janë krijuar kushtet, pasi që në Ligjin për Trepçën është lejuar kjo rentë prej 20% për shëndetësi, ambient, infrastrukturë, arsim dhe me këtë ndryshim e procedojmë përsëri në komisionet e përhershme.

Pasi që të gjithë anëtarët ishin për këtë, Komisioni vendosi që ta tërheqë Raportin me rekomandime për Projektligjin për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth saj të datës 14.4.2016, dërguar Komisioneve të përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

- **Ndotja e mjedisit nga gomat e djegura të kompanisë “Fitoprojekt”-i: në fshatin Mirosalë të Ferizajt, propozim i deputetit Adem Salihaj.**

Adem Salihaj, tha se në fshatin Mirosalë të Komunës së Ferizajt është fabrika “Fitoprojekt”, që merret me përpunimin dhe djegjen gomave të vjetra. Ajo vepron brenda komunitetit në fshat dhe pa leje ndërtimore, pa leje të punës dhe banorët kanë protestuar disa herë, sepse tymi i tyre e ndotë ambientin dhe u bënë të pamundur jetën banorëve që janë 30 metra larg fabrikës. Të kërkojmë nga MMPH-a një informatë pse po

ndodhë kjo. Sa jam i informuar, MMPH-ja e ka lëshuar një leje mjedisore për këtë dhe në mbledhjen e radhës duhet ta diskutojmë si pikë të rendit të ditës, sepse ne jemi përgjegjës për këtë.

Me këtë rast u vendos që të kërkohet informatë nga MMPH-ja për këtë problem dhe në mbledhjen e radhës, të futet si pikë e rendit të ditës.

- **Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma, propozim i kryetares, Duda Balje**

Duda Balje, tha se pasi që grupi punues nuk është taku tash një kohë të gjatë dhe nuk i ka përfunduar akoma amendamentet, propozoi që ky Projektligj të përfundohet nga Komisioni, ndërsa propozoi që amendamentet të përfundohen në mbledhjen e radhës së Komisionit, dhe si pikë e rendit të ditës *të shqyrtohet Projektligjit për Mbrojtjen nga Zhurma.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

**Kryetarja e Komisionit,
Duda Balje**